logo Image not found or type unknown

Platforma për të Drejtat e Njeriut

Constitutional Articles: Dinjiteti i Njeriut

Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut

Constitutional Paragraph: Neni 23

Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut

Instrumentet ndërkombëtare	**Nenet**
PNDCP Pakti Nderkombëtar pët të Drejtat civile dhe Politike	Neni 10 1. Të gjithë personat e privuar nga liria, duhet t? trajtohen me humaniz?m dhe respekt p?r dinjitetin e lindur t? njeriut.
DUDNJ Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut	Neni 22 Secili, si anëtar i shoqërisë, ka të drejtë sigurimi social dhe t? drejta t? domosdoshme ekonomike, sociale e kulturore për dinjitetin e tij dhe për zhvillimin e lirë të personalitetit t? tij, me ndihmën e shtetit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar dhe në përputhje me organizimin dhe burimet e çdo shteti.

Instrumentet ndërkombëtare	**Nenet**
KDF Konventa për të Drejtat e Fëmijës	Neni 23 Shtetet Palë pranojnë se fëmija me paaftësi mendore ose fizike duhet të bëjë një jetë normale dhe të përshtatshme, në kushte që garantojnë dinjitetin e tij, që nxisin autonominë dhe lehtësojnë pjesëmarrjen e tij aktive në jetën e bashkësisë. 2. Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës me paaftësi për kujdes të posaçëm dhe nxisin e sigurojnë, brenda mundësive të të ardhurave të disponueshme, dhënien fëmijës, i cili përmbush kushtet, si dhe atyre që kujdesen për të, të ndihmës që kërkohet dhe që i përshtatet gjendjes së fëmijës dhe gjendjes financiare të prindërve të tij, ose të atyre që kujdesen për të. 3. Duke njohur nevojat e veçanta të fëmijës me paaftësi, ndihma e dhënë sipas paragrafit 2 të këtij neni jepet falas sa herë të jetë e mundur, duke pasur parasysh burimet financiare të prindërve të tij ose të atyre që kujdesen për të dhe kjo synon që fëmijët me paaftësi të kenë mundësi efektivisht të marrin arsim, kualifikim, shërbime shëndetësore, shërbime riaftësimi, përgatitje për punësim dhe veprimtari argëtuese, në mënyrë që fëmija të sigurojë një integrim shoqëror dhe zhvillim vetiak sa më të plotë, përfshirë zhvillimin e tij kulturor dhe shpirtëror. 4. Shtetet Palë, në frymën e bashkëpunimit ndërkombëtar, nxisin shkëmbimin e informacionit të përshtatshëm në fushën e kujdesit shëndetësor parandalues dhe të trajtimit mjekësor, psikologjik dhe funksional të fëmijëve me paaftësi, përfshirë përhapjen dhe mundësinë e marrjes së informacionit lidhur me metodat e riaftësimit, edukimit dhe shërbimeve të formimit profesional, me qëllim që Shtetet Palë të kenë mundësi të përmirësojnë cilësitë dhe aftësitë e tyre dhe të zgjerojnë përvojën e tyre në këto fusha. Në këtë drejtim, duhet të mbahen parasysh në mënyrë të veçantë nevojat e vendeve në zhvillim.

Ligjet	**Nenet**
	Neni 23
LKD Ligji Nr. 05/L -021 për mbrojtje nga diskriminimi	6. Gjobë në shumë prej katërqind e pesëdhjetë (450) deri në shtatëqind e pesëdhjetë (750) euro i shqiptohet për kundërvajtje, secilit që cenon dinjitetin e personit të caktuar ose për krijimin, qasjen apo aplikimin e mjedisit kërcënues, armiqësor, poshtërues ose frikësues.
	Neni 4
LDP Ligji nr. 06/l-082 për mbrojtjen e të dhënave personale	1. Parimi i ligjshmërisë, drejtësisë dhe transparencës - të dhënat personale përpunohen në mënyrë të paanshme, të ligjshme dhe transparente, pa e cenuar dinjitetin e subjekteve të të dhënave.

Ligjet	Nenet
KDM Kodi nr. 06/l-006 i drejtësisë për të mitur	Neni 4.6 Çdo i mitur i privuar lirie trajtohet me humanizëm për hir të dinjitetit të personalitetit të tij njerëzor, dhe me atë rast merren parasysh nevojat personale të moshës së tij. Në veçanti, çdo i mitur i privuar lirie ndahet nga madhorët, përpos nëse konsiderohet se është në interes të miturit të mos ndahet, dhe gëzojnë të drejtën e mbajtjes së kontakteve me familjen e tij përmes korrespondencave dhe vizitave, përveç rrethanave të jashtëzakonshme të përcaktuara me ligj.
LA Ligji nr. 06/l- 026 për azil	Neni 85 Republika e Kosovës do të ndërmarrë masat e nevojshme për t'ua bërë të mundur kthimin vullnetarë personave nën mbrojtje plotësuese ose atyre të cilëve mbrojtja e përkohshme iu ka përfunduar. Republika e Kosovës do të sigurohet se dispozitat që rregullojnë kthimin vullnetarë të personave nën mbrojtje të përkohshme lehtësojnë kthimin e tyre duke respektuar dinjitetin njerëzor. Republika e Kosovës do të sigurohet se vendimi lidhur me kthimin e këtyre personave është marrë duke njohur plotësisht faktet.
LBGJ Ligji për Barazi Gjinore Nr. 05/L -020 -2015	Neni 23 3. Gjobë në shumë prej pesëqind (500) deri në shtatëqind (700) euro do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit përgjegjës ose personit tjetër në personin juridik, organit me autorizime publike ose individit i cili në formë të profesionit të regjistruar kryen veprimtari të caktuar, i cili në bazë gjinore do ta shkelë dinjitetin e personit të caktuar ose krijon mjedise, qasje ose praktikë kërcënuese, armiqësore, ofenduese ose shqetësuese (neni 3 nënparagrafi 1.1, 1.11, 1.12 të këtij ligji
LESP Ligji për ekzekutimin e sankioneve penale NR. 04/L-149 dhe Ligji Nr. 05/L -129 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-149 për ekzekutimin e sanksioneve penale i Kosovës.	Neni 5.1 1. Sanksionet penale ekzekutohen në mënyrën e cila siguron trajtimin human dhe respektimin e dinjitetit të secilit individ. Personi i dënuar nuk i nënshtrohet torturës ose trajtimit, apo ndëshkimit çnjerëzor apo degradues.
LSDPPT Ligji Nr. 05/L -067 PËR STATUSIN DHE TË DREJTAT E PERSONAVE PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK	Neni 4 Përfituesit e këtij ligji mbrohen nga të gjitha llojet dhe format e diskriminimit, shfrytëzimit, abuzimit, fyerjes dhe gëzojnë të drejtat dhe liritë e tyre në mënyrë të barabartë me të tjerët bazuar në Kushtetutën dhe ligjet në fuqi, standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të njohura nga Konventat Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut e me theks të veçantë me standardet dhe parimet e përcaktuara me Konventën Ndërkombëtare për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar

Ligjet	Nenet
	Neni 38
LMF LIGJI NR. 06/L-084 PËR MBROJTJEN E FËMIJËS	2. Është e ndaluar që një fëmijë të kthehet në subjekt të torturës dhe trajtimit jo njerëzor, jo dinjitoz, ndëshkimit trupor dhe trajtimit degradues nga secili person
LPKSH Ligji Nr.2004/38 PËR TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E QYTETARËVE NË KUJDESIN SHËNDETËSOR	Neni 6.1 Gjatë trajtimit mjekësor duhet të respektohen: dinjiteti, jeta private, integriteti personal dhe bindjet religjioze të qytetarit

decisionTitle*	decisionDescription*
Aziatikët e Afrikës Lindore kundër Mbretërisë së Bashkuar (3 E.H.R.R. 76) 15 Dhjetor 1973	Përmbledhje: Burrave te shtetasve të Britanisë së Madhe që tashmë banojnë në Mbretërinë e Bashkuar iu mohua hyrja në përputhje me Ligjin e Emigrantëve të Commonwealth të vitit 1962, të ndryshuar me Ligjin e Emigrantëve të Commonwealth të vitit 1968 dhe Ligjin e Ankesave të Emigracionit të 1969. Ligji i nënshtrohej kontrollit të imigracionit qytetarëve të Mbretërisë së Bashkuar dhe kolonive të Afrikës Lindore që ishin me origjinë aziatike. Ligji përjashtoi nga imigrimi gratë e shtetasve të Komonuelthit, me banim në Mbretërinë e Bashkuar, por nuk siguroi një përjashtim të ngjashëm për burrat. **Diskriminimi racor, trajtimi degradues (neni 3)** Për të veçuar publikisht një grup personash për trajtim diferencial mbi bazën e racës mund të përbëjë një formë të veçantë të keqtrajtimit ndaj dinjitetit njerëzor dhe prandaj mund të jetë i aftë të krijojë një trajtim degradues në kundërshtim me nenin 3
Ramirez Sanchez v. France [GC], no. 59450/00	Në këtë çështje Gjykata theksoi se shteti duhet të sigurojë që të burgosurit që arrestohen të kenë kushte që janë në përputhje me respektimin e dinjitetit të tyre njerëzor, dhe që mënyra dhe metoda e ekzekutimit të masës nuk i krijon shqetësime ose vështirësi me një intensitet që tejkalon nivelin e pashmangshëm të vuajtjes, dhe që, duke pasur parasysh kërkesat praktike të burgimit, shëndeti dhe mirëqenia e tyre të jenë siguruar në mënyrë adekuate. Svinarenko and Slyadnev v. Russia [GC], nos 32541/08 and 43441/08, § 133, 17 July 2014
Svinarenko and Slyadnev v. Russia	GJEDNJ arriti në përfundimin se ‘mbajtja e një personi në një kafaz metalik gjatë një procesi gjyqësor përbën në vetvete - duke pasur parasysh natyrën e tij objektive degraduese e cila është e papajtueshme me standardet e sjelljes së qytetëruar që janë shenjë dalluese e një shoqërie demokratike - një sulm ndaj dinjitetit njerëzor duke shkelur nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.